

Syllabusi i lëndës

Lënda: AKAID IV – *Studim krahasimtar i feve*

Programi i studimit: **Teologji islame**

Numri i ECTS kredive: **6**

Statusi i lëndës: **Obligative**

Kodi i lëndës: **402**

Fondi i orëve: **2+2**

Viti akademik: 2024/2025

Semestri: **VII**

Mësimdhënësi: **Prof. ass. dr. Zija Abdullahu** Kontakti: e-maili: zabdullai@hotmail.com

Përmbajtja e shkurtër i lëndës

Kjo lëndë studion fetë më kryesore dhe më gjerësisht të shtrira në botë. Studimi ndahet në dy pjesë, në fe të shpikura dhe fe në esencën e tyre të shpallura. Nga fetë e shpikura do të studiohen: Zoroastrizmi, Hinduizmi, Budizmi, Xhainizmi, Sikizmi, Taoizmi, Konfuçionizmi, dhe Shintoizmi. Ndërsa nga fetë e shpallura, Judaizmi dhe Krishterimi. Studimi përmban një pasqyrë të shkurtër të zhvillimit historik të secilës fe, besimet më kryesore, ngjashmëritë, krahasimin mes tyre, dhe gjendjen aktuale. Krahasimi me theks më të veçantë studiohet ndërmjet feve të shpallura, gjegjësisht ndërmjet Judaizmit, Krishterimit dhe Islamit, duke nxjerrë në pah të përbashkëtat që kanë këto fe mes vete, dhe dallimet, si në burimet, besimet, ceremonitë, adhurimet, jetën fetare dhe sektet e tyre.

Qëllimi i lëndës

Pajisja e studentëve me njohuri bazë nga lëmi i Krahasimit të feve, duke hulumtuar dhe studiuar fetë më të rëndësishme dhe më me shtrirje të gjerë në botë. Zhvillimi i shkathësive dhe aftësive për të analizuar të dhënat e feve të ndryshme të cilat përfshinë programi studimor në mënyrë që të mund të nxjerrin konkluzione për to. Fitimi dhe avancimi i sensit të kritikës në aspektin e vlerësimit të argumenteve bazuar në fakte përkatëse të feve. Aftësimi për të shkruar ese apo për të diskutuar për to, në një stil të pastër dhe bindës të të shprehurit me gojë dhe me shkrim, tipare këto të një personi me një edukim liberal akademik. Prej leksioneve nga Krahasimi i feve presim që studenti pas përfundimit të këtij kursi do të përfitojë kulturë të përgjithshme mbi fetë më dominuese në arenën ndërkombëtare, siç është Zoroastrizmi, si dhe fetë më dominuese në Indi, Kinë dhe Japoni. Po ashtu edhe Hebraizmi e Krishterimi fe me të cilat kemi shumë gjëra të përbashkëta, mbase në esencën e tyre janë fe të shpallur. Të kuptojë proceset e zhvillimit që nga formimi i tyre e deri në ditët e sotme. T'i jepet mundësi studentit që në formë kritike duke nxitë

debate, t'i kuptoj se çështjet e përbashkëta që i afrojnë mes veti fetë janë shumë më shumë se ato që i ndajnë. Të kuptojë se zhvillimi i Krahasimit të feve ka një trend pozitiv të ngritjes së tolerancës në shoqëri, dhe se Krahasimi i feve duhet të zhvillohet dhe të avancohet ditë e më shumë, mbase është në interes të bashkëjetesës dhe të paqes në rajon dhe në botë.

Rezultatet e pritura të nxënies:

Pas përfundimit të kursit, studenti do të jetë në gjendje të:

Të përshkruaj etapat e zhvillimit të feve më dominuese në botë.

Të krahasoj ndërmjet feve të ndryshme të cilat i studion gjatë kursit.

Të diskutoj rreth këtyre feve në bazë të argumenteve të secilës fe, duke qenë sa më objektiv në parashtrimin e tyre.

Të mbroj qëndrimet e secilës fe, ashtu siç i konceptojnë ithtarët e tyre.

Të prezantoj mendimin kritik ndaj secilës prej tyre, duke paraqitur atë më të vlefshmin.

Të jetë në gjendje që njohuritë e fituara t'i aplikoj në relacionet ndërfaqetare.

Metodologjia e mësimdhënies:

- Ligjërata
- Analiza dhe diskutime interaktive
- Prezantime të projekteve grupore dhe individuale
- Prezantimi i audio dhe video materialeve

Përmbajtja e lëndës:

Java e parë: Hyrje, Njohja me syllabusin, metoda, organizimi, kërkesat dhe vlerësimi. Shqyrtime të përgjithshme: Feja si fenomen mbarënjëzësorë. Relacioni i fesë me shkencat e tjera. Dallimi ndërmjet filozofive dhe feve të sajara. Frytet e besimit në fe. Historiku i Islamit në kaluarën dhe në të tashmen. Kontributi i muslimanëve në studimet krahasimtare të feve. Metodologjia e dijetarëve islam në studimin e feve. Studimi krahasimtar i feve te shqiptarët. Frytet e shkencës së krahasimit të feve. Fetë e sajara: Feja në Persinë e Lashtë-*Zoroastrizmi*; 1- Jeta dhe vepra e Zoroastrit. 2- Besimet; 3- Adhurimi i zjarrit. 4-Libri i shenjtë. 5- Sektet. 6-Gjendja e sotme e Zoroastrizmit. Propozimi i temave për punime seminarike dhe për ese.

Literatura: Dr. Zija Abdullahu, *Studim krahasimtar i feve*, f. 11-60. (Në vazhdim do të jetë kjo literaturë bazë, andaj do të mjaftohemi vetëm me cekjen e faqeve).

Java e dytë: FETË MË TË RËNDËSISHME NË INDI; *HINDUIZMI*: 1-Besimet. 2-Adhurimet dhe ligjet hinduse. 3-Mësimi i dominimit ndaj vetes – *Ahimsa*, 4-Libri shenjtë i hinduizmit, 5-Kremtet fetare dhe zakonet. *BUDIZMI*: 1-Zanafilla; Ndriçimi (Nirvana) dhe zbulimi i fshehtësive. 2-Besimet. 3-Adhurimet. 4-Librat e

shenjtë. 5-Qëndrimi i Budës ndaj; pasurisë, punës dhe gruas. 6-Anulimi i kastave. 7-Festat dhe kremtimet. 8-Ndarja e Budistëve. 9-Porositë e Budës. 10-Shkaqet e përhapjes së shpejtë. 11-Mendimet e budistëve ndaj Budës. 12-Budizmi sot. Bisedë interaktive, rreth qëndrimit të Budës ndaj pasurisë, gruas, dhe punës dhe atij islam ndaj këtyre çështjeve.

Literatura: (f. 61-98)

Java e tretë: *XHAINIZMI:* 1-Zanafilla. 2-Doktrina. 3-Besimet. 4-Adhurimet dhe ceremonitë. 5-Librat e shenjtë. 6-Doktrina e shpëtimit. 7-Mësimet etike. 8-Fraksionet. 9-Xhainizmi sot: *SIKIZMI:* 1-Zanafilla; 2- Besimet. 3-Libri i shenjtë. 4-Ritualet e adhurimit. 5-Rregullat e tjera fetare. 6-Ceremonitë. 7-Fraksionet. 8-Zhvillimi i historik i identitetit të sikëve. 9-Sikizmi sot. Debat mbi të përbashkëtat e Sikizmin me Islamin, dhe dallimet esenciale.

Literatura: (f. 98-123)

Java e katërt: FETË MË TË RËNDËSISHME NË KINË. *TAOIZMI:* 1-Themeluesi i Taoizmit. 2-Nga filozofia në fe. 3-Besimet. 4-Librat e Taoizmit. 5-Ritualet dhe ceremonitë fetare. 6-Kalimi në idhujtari. 7-Taoizmi sot. *KONFUÇIZMI:* 1-Zanafilla. 2-Doktrina. 3-Besimet. 4-Librat e shenjtë. 5-Sektet. 6-Dallimi me fetë tjera. 7-Ngjarjet më kryesore në historinë e Konfuçizmit. 8-Konfuçizmi sot. Propozim për temat seminarike

Literatura: (f. 125-151).

Java e pestë: *SHINTOIZMI:* 1-Zanafilla. 2-Depërtimi i Budizmit dhe Konfuçizmit. 3-Besimet. 4- Tempujt dhe ritualet e adhurimeve. 5-Librat e shenjtë. 6-Festat. 7-Sektet. 8-Feja japoneze si mision për okupimin e botës. 9-Periudhat e Shintoizmit. 10-Shintoizmi sot. *HEBRAIZMI (JAHUDIZMI).* HISTORIA E HEBRAIZMIT: 1-Zanafilla. 2-Pozita gjeografike dhe demografike. 3-Origjina e hebrenjve dhe emigrimi i h. Ibrahimit në Palestinë. 4-Izolimi i hebrenjve. 5-Transferimi i h. Jakubit a.s. me djemtë e tij në Egjipt. 6-Ndodhitë pas ikjes së izraelitëve nga Egjipti. 7-Hyrja e bijve të Izraelit në tokën Palestineze. 8-Okupimi i Izraelitëve. 9-Hebrenjtë në kohën modern. 10-Formimi i shtetit kombëtarë Izraelit. Bisedë interaktive mbi fetë e sajuara dhe ato të shpallura.

Literatura: (f. 153-210).

Java e gjashtë: *Librat e Shenjtë të Hebraizmit:* 1-Dhiata e Vjetër ; Tora\ Tanah \ Tivrati. 2-Ndarja e Dhiatës së Vjetër te të krishterët. 3-Përmbajtja e librave apokrofike. 4-Besueshmëria e Dhiatës së Vjetër dhe mendimet rreth saj. 5-Qëndrimi islam ndaj librave të shpallura më parë. 6-Talmudi. *Besimet Hebraike:* 1-Jahudizmi dhe emri i Zotit;. 2-Koncepti i pejgamberisë. 3-Koncepti i ringjalljes 4-Koncepti i “Mesiut të premtuar”. 5-Mesiu në tekstet islame. Bisedë interaktive, rreth Torës, Talmudit dhe Kur’anit.

Literatura: (f. 211-284)

Java e shtatë: *Jeta fetare në Jahudizëm:* 1-Përkufizimi i identitetit Jahudit. 2-Rregullat dhe mënyra e adhurimeve;. 3-Festat fetare, dhe periudhat e kremtimeve. 4-Simbolet. 5-Jeta familjare.; synetimi, *Bar Micva*, ceremonia e varrimit, kutia rikujtuese, rregullat e ushqimit, ndalimi i kamatës. Sektet në Jahudizëm: 1-Samarenjtë. 2-Farisenjtë (hebr. Perushim). 3-Saducenjët (hebr. Tzedukim). 4-Zelotët (të hidhëruarit \ të revoltuarit). 5-Karaitët (lexuesit; hebr. Karaim). 6-Misticizmi jahudit. 7-Hasidizmi dhe misticizmi islam. 8-Jahudizmi në diasporë; Ashkenazët, Sefardët. Testi i parë, studentët ndahen në dy grupe për këtë test.

Literatura: (f. 285-322).

Java e tetë: *Pasqyrë e shkurtër historike e Krishterimit.* Krishterimi sipas Kuranit famëlartë. Jeta e Isait a.s. në Kur'an. Pejgamberia dhe muxhizet/mrekullit e tij në Kuran. Jezusi/Isai në Krishterim. Jeta e Jezusit. Apostujt (havarinjët) e Jezusit. Pse vdiq Zoti- Jezu Krisht. Krishterimi pas Jezusit. Krishterimi dhe përndjekjet. Debat rreth apostujve në pikëpamjen islame dhe atë krishtere.

Literatura: (f. 325-360)

Java e nëntë: *Përçarjet krishtere.* Sauli\Pali. Armiqësia e tij me më të afërmit e mëparshëm. Pali pranon shpallje dhe bën mrekulli. Pali dhe Hebraizmi. Risitë që sollti Pali në Krishterim. *Librat e shenjtë të krishtera.* Dhiata e Re dhe librat e saj. Ungjilli sipas Mateut, Markut, Llukës dhe Gjonit. Veprat e Apostujve. Letrat e apostullit Pal. Letrat katolike, apo letrat krishtere. Bisedë interaktive, për krahasimin e përçarjeve krishtere dhe islame, dhe krahasimit të Palit me Jezusin

Literatura: (f. 360-398)

Java e dhjetë: *Besimet krishtere.* Trinia e Shenjtë. Besimi në Zot-Ati. Besimi në Zot-Biri. Besimi në Zot-Shpirti i Shenjtë. Pikëpamjet islame mbi Trinitetin dhe elementet e tij. Qëndrimi ndaj besimit në Zot-Ati, Zot-Biri, Zot-Shpirti i Shenjtë. Origjina e Trinitetit. Pozita e Marisë\h. Merjemes në Krishterim. Mëkatit i parë. Trashëgimia e mëkatit të parë. Drejtësia e Zotit. Shlyerja e mëkatit vetëm me besimin në gjakderdhje. Bisedë interaktive rreth besimit islame dhe atë të krishterë.

Literatura: (f. 400-450).

Java e njëmbëdhjetë: *Kryqëzimi i Jezusit.* Ngjarja e kryqëzimit. Të dhënat kontradiktore të ungjijve. Koncepti Islam i kryqëzimit. Jezusi gjykatës në jetën e asaj bote. Besimi në Ditën e Ringjalljes. *Jeta fetare në Krishterim.* Misterete e Kishës-sakramentet: Pagëzimi, kungimi, pengimi, mirosja, misteri i priftërinjve, martesë, dhe vajimi. Bisedë interaktive rreth rrëfimit të kryqëzimit të muslimanët dhe të krishterët.

Literatura: (f. 450-478).

Java e dymbëdhjetë: *Adhurimet.* Lutjet drejtuar Zotit-Jezus. Kryqëzimi. Agjërimi. E dhjeta. Pelegrinazhi: *Festat Krishtere.* Koha e Krishtlindjes-Kërshëndellat. Periudha e Pashkëve. Festimi i ditës së diel. Debat rreth pelegrinazhit të

krishterë, haxhillëkut islam, periudhës së Pashkëve dhe Ashurës të Muslimanët.

Literatura: (f. 478-486).

Java e trembëdhjetë: *Këshillat-Koncilet ekumenik*. Koncili i Nikesë (325). Koncili i parë i Konstantinopojës (381). Koncili i parë i Efesit (431). Koncili i Halkedonit (451). Koncili i katërt i Konstantinopojës (869). Koncili i dytë i Vatikanit (1962-65).

Literatura: (f. 488-496)

Java e katërbëdhjetë: : *Sektete fetare krishtere*. Ndarja fillestare. Ebionitët\Hebraiko-krishterët. Docetizmi. Monarshizmi. Arianizmi. Monofizitizmi. Diofizitizmi. Diskutime rreth sekteve krishtere dhe atyre islame.

Literatura: (f. 496-505).

Java e pesëmbëdhjetë: *Ndarja e madhe e Kishës*. Ortodoksizmi. Katolicizmi. Protestantizmi. Rëndësia e Kishës në Krishterim. Kisha dhe pjesët e saj. Hierarkia e Kishës.

Testi, studentët do të ndahen në dy grupe për mbajtjen e testit përfundimtar.

Literatura: (f. 505-538).

Kriteriumi dhe komponentët e vlerësimit:

Pjesëmarrje dhe angazhimi në ligjeratë 10%

Punimi seminarik 20%

Testi intermedier 30%

Provimi final 40%

Total 100%

Literatura obliguese:

1. Dr. Zija Abdullahu, *Studim krahasimtar i feve*, Fakulteti i Studimeve Islame, Prishtinë, 2010

Literatura konsultative:

1. *Kurani*; përkthim dhe komentim, përktheu: H. Sherif Ahmeti. Medinë, 1992
2. *Bibla: Besëlidhja e Vjetër dhe Besëlidhja e Re* (Bibla katolike), përktheu: Don Simon Filipaj, Ferizaj, 1994
3. *Dhiata e Vjetër dhe Dhiata e Re* (Bibla protestante), përktheu: ?, Tiranë, 1999
4. Abdurrahman Solejmani, *Fetë e gjalla të botës*
5. Adnan Silajdžić, *Islami në zbulimin e Evropës krishtere*